




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 7 gusht 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Përmirësohet paragrafi 1, pika 3 e vendimit KGJK.nr.374/2023, i datës 28 korrik 2023, për shkak të një lëshimi teknik, ku në vend të Agron Hoxhaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren, duhet të jetë gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me 7 gusht 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.374/2023, të datës 28 korrik 2023, ka nxjerr vendimin me të cilin Ministrisë së Drejtësisë i janë propozuar anëtarët dhe anëtarët rezervë të tyre për Komisionin Disiplinor ndaj Përmbauesit Privat.

Gjatë hartimit të vendimit të lartcekur, është lëshuar gabim teknik në paragrafin 1 pika 3 sa i përket gjykatës në të cilën ushtron funksionin gjyqtari Hoxhaj.

Me këtë vendim, përmirësohet lëshimi teknik sa i përket paragrafit, pikës të lartcekur, ashtu që duhet të jetë Agron Hoxhaj, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Agron Hoxhaj, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit.